

1 E mërkurë, 11 nëntor 2020

2 [Paraqitja e Parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari Selimi hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes. Mirëserdhët
7 të gjithë që jeni të pranishëm këtu në sallë dhe që na ndiqni
8 nga jashtë.

9 Përpara se të fillojmë, në përputhje me vendimin për
10 caktimin e datës së kësaj seance, fotografi lejohet të bëjë
11 disa fotografi për një minutë e gjysmë. Dhe siç thashë dhe dje
12 edhe një ditë përpara, ju kërkoj që të mos bëni fotografi të
13 të akuzuarit me rojat e sigurisë në sfond. Faleminderit.

14 Ju faleminderit.

15 Z. Sekretar, ju lutem paraqitni lëndën.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda numër
17 KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit,
18 Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Sekretar.

20 Përpara se t'u kërkoj të pranishmëve të prezantohen, dua
21 t'i rikujtoj të gjithë për rregullat që duhet të respektohen
22 gjatë gjithë kohës në mënyrë që kjo seancë të zhvillohet pa
23 pengesa.

24 Ju lutem aktivizoni, ndizni mikrofonin përpara se të
25 flisni dhe fikenit kur të përfundoni.

1 Flisni ngadalë dhe qartë, duke qenë se kemi përkthim prej
2 dhe në gjuhën shqipe dhe serbe.

3 Prisni pesë minuta -- pesë sekonda përpara se të më
4 përgjigjeni mua, apo një pale apo pjesëmarrësi, që t'u
5 mundësojmë përkthyesve të përfundojnë përkthimin.

6 Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptohet në kohë reale
7 dhe do të zbardhet në një procesverbal që do t'u vihet në
8 dispozicion palëve dhe publikut pas seancës.

9 Dua t'i kujtoj palët që një pjesë e informacionit në këtë
10 çështje është objekt i urdhrave për konfidencialitet dhe i
11 masave mbrojtëse. Këtu përfshihet dhe informacioni që është
12 redaktuar nga Aktakuza e Konfirmuar, përkatësisht,
13 informacioni lidhur me identitetin e disa individëve, me data,
14 vende, dhe informacion tjetër konfidencial.

15 Informacion i tillë nuk nxirret në seancë të hapur. Në
16 qoftë se një palë apo pjesëmarrës do të kalojë në seancë
17 private për t'iu referuar një informacioni konfidencial, duhet
18 t'i paraqesë arsyet për këtë.

19 Tani do t'u kërkoja palëve dhe pjesëmarrësve që të
20 prezantohen. Do të filloj me Prokurorinë.

21 Urdhëroni.

22 Z. TIEGER: [Përkthim] Mirëmëngjes i nderuar Gjykatës. Në
23 emër të Prokurorisë sot të pranishëm janë Zëvendësprokurori i
24 Specializuar, Alex Whiting; shefja e Njesisë për Çështje
25 Juridike, Clare Lawson; prokurori, David Harbach; dhe unë

1 Prokuror i Lartë, Alan Tieger.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuror.

3 Tani i drejtohem Mbrojtjes.

4 Z. KAARLS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Në emër të Mbrojtjes,
5 unë jam Robert Kaarls. Do të caktohet edhe avokati kryesor, që
6 do të jetë David Young. Për shkak të KOVIDIT ai nuk mund të
7 jetë i pranishëm sot në këtë seancë, por besoj që do të jetë
8 këtu në Holandë, do të vijë nga Mbretëria Britanike javën e
9 ardhshme.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për hir të procesverbalit,
11 i pranishëm në sallë është edhe z. Selimi.

12 Tani Administratorja.

13 ADMINISTRATORJA: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Fidelma
14 Donlon, Administratore.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

16 Dhe për procesverbalin, unë jam Nicolas Guillou, Gjykatës
17 i Procedurës Paraprake në këtë çështje.

18 I akuzuari paraqitet për herë të parë sot para Dhomave të
19 Specializuara pas një Aktakuze të Konfirmuar kundër tij.

20 Z. Selimi, ju lutem ngrihuni në këmbë. A mundeni, ju
21 lutem, të na e jepni emrin dhe mbiemrin?

22 I AKUZUARI SELIMI: Jam Rexhep Selimi, i lindur më 15
23 mars 1971.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vendi i lindjes dhe
25 shtetësia?

1 I AKUZUARI SELIMI: Aqarevë, komuna Skënderaj, Kosovë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe keni shtetësinë
3 kosovare?

4 I AKUZUARI SELIMI: Po, jam shtetas i Republikës së
5 Kosovës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit. Mund të
7 uleni z. Selimi.

8 Tani do të kaloj te historiku procedural i çështjes.

9 Më 26 tetor 2020, si Gjykatës i Procedurës Paraprake
10 konfirmova Aktakuzën e parashtruar nga Prokurori i
11 Specializuar kundër të akuzuarit, ku përmbahen gjashtë akuza
12 për krime kundër njerëzimit, përkatësisht, përndjekje,
13 burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, dhe
14 zhdukje me forcë e personave; dhe katër akuza për krime lufte,
15 gjegjësisht, për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe
16 vrasje të paligjshme.

17 I akuzuari u arrestua në Kosovë më 5 nëntor 2020. U
18 transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
19 Specializuara të Kosovës në Hagë në të njëjtën ditë.

20 Z. Selimi, përpara se të vazhdojmë dua që të sigurohem se
21 mund ta ndiqni këtë seancë, këtë procedurë, në një gjuhë që e
22 kuptoni dhe flisni. A mundeni, ju lutem, të më konfirmoni se e
23 flisni dhe e kuptoni gjuhën shqipe?

24 I AKUZUARI SELIMI: Po, e flas dhe e kuptoj shumë mirë
25 gjuhën shqipe.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Selimi.
2 Me konfirmimin tuaj jam i bindur se mund t'i ndiqni procedurat
3 në shqip, një gjuhë që e kuptoni dhe e flisni, në përputhje me
4 rregullën 92 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

5 Z. Selimi, në qoftë se në ndonjë moment gjatë kësaj
6 seance nuk e dëgjoni përkthimin, atëherë ju lutem të ma bëni
7 këtë me dije menjëherë.

8 Tani më lejoni që ta shpjegoj qëllimin konkret të seancës
9 së Paraqitjes së Parë për nevojat e të të akuzuarit dhe atyre
10 që na ndjekin nga galeria për publikun dhe online.

11 Seanca e sotme nuk është gjykim. Në këtë seancë nuk
12 paraqiten dhe debatohen prova, dhe nuk diskutohet fajësia apo
13 pafajësia e të akuzuarit dhe as që merret vendim në lidhje me
14 të. Qëllimi i kësaj seance rregullohet me nenin 39 të Ligjit
15 dhe rregullën 92 të Rregullores.

16 Sipas këtyre dispozitave, unë si Gjykatës i Procedurës
17 Paraprake kam për detyrë që:

18 t'ia lexoj akuzat nga Aktakuza e Konfirmuar të akuzuarit
19 në një gjuhë që ai e kupton dhe e flet;

20 të konfirmoj se i akuzuari e kupton Aktakuzën;

21 të bindem se të drejtat e të akuzuarit, dhe sidomos e
22 drejta e tij për të pasur avokat mbrojtës, janë respektuar;

23 ta informoj të akuzuarin se brenda 30 ditësh nga seanca e
24 sotme ai do të ftohet që të vetëdeklarohet për fajësi ose
25 pafajësi lidhur me secilën pikë të Aktakuzës. Në qoftë se i

1 akuzuari dëshiron ta bëjë këtë, ai mund ta bëjë këtë
2 menjëherë, pra, të vetëdeklarohet lidhur me fajësinë ose
3 pafajësinë;

4 Dhe së fundi, do të caktoj edhe data të tjera, sipas
5 rastit, në kryerjen e detyrës sime si Gjykatës i Procedurës
6 Paraprake.

7 Pres prej palëve që t'u përmbahen këtyre çështjeve,
8 pikave që do t'i trajtojmë një nga një. Në qoftë se ndonjëra
9 prej palëve do të diskutojë apo ngrejë një çështje që nuk
10 është paraparë në kuadër të kësaj seance, atëherë këtë mund ta
11 bëjnë me shkrim duke parashtruar parashtrime me shkrim.

12 Së pari, z. Selimi, a mund të më konfirmoni që e keni
13 marrë Aktakuzën e Konfirmuar të datës 4 nëntor 2020 në një
14 gjuhë që e kuptoni dhe e flisni?

15 I AKUZUARI SELIMI: Po, konfirmoj që e kam marrë
16 Aktakuzën në gjuhën shqipe. Një Aktakuzë e redaktuar, siç jeni
17 ju në dijeni. Faleminderit.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.

19 Tani do të kërkoj nga Sekretari i Gjykatës që t'i lexojë
20 akuzat nga Aktakuza e Konfirmuar sikurse parashikohet në nenin
21 39 të Ligjit dhe rregullën 92.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim]

23 1. Në Aktakuzën e Konfirmuar, Prokurori i Specializuar
24 akuzon z. Rexhep Selimi për:

25 Pika 1: Përndjekje, krim kundër njerëzimit i

1 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(h) të Ligjit;

2 Pika 2: Burgosje, krim kundër njerëzimit i ndëshkueshëm
3 në bazë të nenit 13(1)(e) të Ligjit;

4 Pika 3: Ndalim arbitrar si krim lufte, i ndëshkueshëm në
5 bazë të nenit 14(1)(c) të Ligjit;

6 Pika 4: Akte të tjera çnjerëzore si krim kundër
7 njerëzimit, i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(j) të
8 Ligjit;

9 Pika 5: Trajtim mizor si krim lufte, i ndëshkueshëm në
10 bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

11 Pika 6: Torturë si krim kundër njerëzimit, i
12 ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(f) të Ligjit;

13 Pika 7: Torturë si krim lufte, i ndëshkueshëm në bazë të
14 nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit;

15 Pika 8: Vrasje si krim kundër njerëzimit, i ndëshkueshëm
16 në bazë të nenit 13(1)(a) të Ligjit;

17 Pika 9: Vrasje e paligjshme si krim lufte, i
18 ndëshkueshëm në bazë të nenit 14(1)(c)(i) të Ligjit; dhe

19 Pika 10: Zhdukje me forcë e personave, krim kundër
20 njerëzimit i ndëshkueshëm në bazë të nenit 13(1)(i) të Ligjit.

21 2. Këto krime u kryen midis afërsisht prillit 1998 dhe
22 gushtit 1999, në një numër vendesh në Kosovë dhe në Shqipërinë
23 veriore, ndër të cilat:

24 a. Bare, Bajgorë, Llapashticë, Majac, Potok dhe vende të
25 tjera në komunën e Podujevës; Drenoc dhe vende të tjera në

1 komunën e Rahovecit; Malet e Berishës, Llapushnik dhe vende të
2 tjera në komunën e Drenasit; Ferizaj dhe vende të tjera në
3 komunën e Ferizajt; Gjilan në komunën e Gjilanit; Jabllanicë
4 në komunën e Gjakovës; vende në komunën e Kaçanikut; Kleçkë
5 dhe vende të tjera në komunën e Lipjanit; Likoc dhe vende të
6 tjera në komunën e Skënderajt; Malishevë dhe vende të tjera në
7 komunën e Malishevës; në Shpellën e Volljakës në komunën e
8 Klinës; Novobërdë në komunën e Novobërdës; Zllash dhe vende të
9 tjera në komunën e Prishtinës; Prizren dhe vende të tjera në
10 komunën e Prizrenit; Suharekë dhe vende të tjera në komunën e
11 Suharekës; dhe vende në komunën e Vitisë.

12 b. dhe në Cahan dhe Kukës në Shqipërinë veriore.

13 3. Krimet në pikat 1, 2, 4, 6, 8, dhe 10 u kryen si
14 pjesë e një sulmi gjerësisht të përhapur dhe sistematik të
15 drejtuar kundër popullatës civile në Kosovë dhe në Shqipërinë
16 veriore, duke filluar së paku nga marsi '98 e deri në shtator
17 të vitit '99. Në veçanti, këto krime kishin në shënjestër
18 kundërshtarët të cilët perceptoheshin se: (i) kishin
19 bashkëpunuar, ose kishin lidhje me forca, zyrtarë ose
20 institucione shtetërore të Republikës Federale të Jugosllavisë
21 (RFJ), ose (ii) ndryshe, nuk përkrahnin qëllimet dhe metodat e
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe më pas të Qeverisë së
23 Përkohshme të Kosovës, duke përfshirë edhe persona që kishin
24 lidhje me Lidhjen Demokratike të Kosovës, dhe persona të
25 përkatësisë etnike serbe, rome, dhe të tjera.

4. Krimet në pikat 3, 5, 7 dhe 9 u kryen kundër personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime, dhe në kontekstin e dhe në lidhje me konfliktin e armatos jondërkombëtar në Kosovë midis forcave të UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësitet të Ushtrisë Jugosllave, njësitet policore dhe njësitet të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe Serbisë, duke filluar nga së paku marsi i vitit '98-të e deri në afërsisht 16 shtator '99.

5. Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale, në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit për:

a. kryerje, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët, të krimeve në pikat 1 deri në 10, ose në alternativë, pra, kryerje, si anëtar i ndërmarrjes kriminale të përbashkët të lartpërmendur, të krimeve në pikat 1 deri në 10, duke qenë i vetëdijshëm se këto krime mund të kryheshin gjatë zbatimit të qëllimit të përbashkët të ndërmarrjes kriminale të përbashkët dhe duke e ndërmarrë këtë rrezik me vullnet të lirë; dhe/ose

b. për ndihmimin dhe inkurajimin e krimeve në pikat 1 deri në 10.

6. Gjithashtu dhe në alternativë, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale, në bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit, si epror për krimet e paraqitura në

1 pikat 1 deri në 10.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Sekretar i
3 Gjykatës.

4 Z. Selimi, dëshiroj t'ju kujtoj se kjo nuk është koha për
5 të kontestuar akuzat, por thjesht që të pranoni se i kuptoni
6 akuzat. Do të keni mundësi të bollshme për t'i kundërshtuar
7 akuzat me ndihmën e avokatit tuaj.

8 Z. Selimi, a i kuptuat akuzat që përmbahen në Aktakuzën e
9 Konfirmuar që i lexoi Sekretari i Gjykatës?

10 Z. KAARLS: [Përkthim] Z. Selimi do që t'i përgjigjet
11 pyetjes tuaj, po dëshiron edhe të bëjë një deklaratë të
12 shkurtër për Gjykatën.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për sa kohë që është e
14 shkurtër dhe që lidhet me çështjen, z. Selimi mund të flisni.

15 I AKUZUARI SELIMI: Ju faleminderit i nderuar z. Gjyqtar.

16 E di që ndoshta këtu nuk është momenti as vendi që të
17 flas për legjitimitetin e kësaj Gjykate, duke e ditur se këtë
18 Gjykatë e ka themeluar Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dua të
19 theksoj po ashtu, se unë si deputet i atij Kuvendi e pata
20 kundërshtuar themelimin e kësaj Gjykate, jo si shprehje kundër
21 drejtësisë, po përkundrazi, donim që drejtësia të bëhej nga
22 institucionet e Republikës së Kosovës në Kosovë.

23 Më lejoni t'ju kujtoj, i nderuar z. Gjykatës, se pasi që
24 Kosova shpalli pavarësinë e saj, Serbia e pat paditur Kosovën
25 në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me pretendimet

1 e saj se shpallja e pavarësisë ishte e paligjshme
2 ndërkombëtarisht. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare ishte në
3 favor të Kosovës dhe i dha legjitimitet pavarësisë së Kosovës.
4 Por vetëm pak muaj pas këtij vendimi të Gjykatës Ndërkombëtare
5 të Drejtësisë, Serbia përmes senatorit Dick Marty nxori një
6 raport si kundërpeshë ndaj vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare
7 të Drejtësisë, dhe veçanërisht si kundërpeshë ndaj pavarësisë
8 së legjitimuar të Republikës së Kosovës.

9 Prandaj mendoja që nuk duhej të ngrihej një gjykatë mbi
10 synimet e hapura antishqiptare dhe anti-Kosovë.

11 Sidoqoftë, ja ku jemi. Kjo Gjykatë tash është një fakt. E
12 unë sot këtu nuk jam si deputet që e kam kundërshtuar këtë
13 Gjykatë, por jam si një luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës dhe si një ndër themeluesit e saj, përballë një
15 Aktakuze të ngritur nga ana e Prokurorisë dhe të konfirmuar
16 nga ju, i nderuar Gjykatës, i vetëdijshëm për rëndësinë dhe
17 seriozitetin e kësaj çështje.

18 I nderuar z. Gjykatës, zotërinj Prokurorë, rolet këtu i
19 kemi të ndara. Jemi palë të ndryshme, po ju lutem më bëni të
20 besoj se po ashtu qëllimi i të gjithë neve këtu do të jetë
21 drejtësia, e mbi të gjitha e vërteta.

22 E pashë Aktakuzën e ngritur nga ana e Prokurorisë. Ishte
23 një Aktakuzë e rëndë, voluminoze, po mbi të gjitha shumë e
24 padrejtë. E pasaktë dhe e padrejtë ndaj meje, por e padrejtë
25 edhe ndaj luftës së popullit tim dhe shtetit prej nga vij unë.

Po vetë ky proces do ta dëshmojë se ne ishim një popull i shtypur që luftuam për liri. Lufta e popullit tim ishte e drejtë, çlirimtare, me qëllime të drejta e fisnike. Bëmë një luftë të pastër dhe të drejtë dhe se kjo luftë do të jetë e tillë edhe pas këtij procesi, sepse secili që ka dyshime do të bindet se as unë e as Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kemi të bëjmë asgjë me krime e as me ndërmarrje të përbashkët kriminale, siç cilësohemi padrejtësisht në këtë Aktakuzë.

Po, unë kam luftuar kundër Serbisë, kundër Serbisë okupatore. Kundër një Serbie që veç të këqija i ka sjellë vendit tim. Vrasje, dëbime, dhunë, shfarosje, poshtërim, spastrim etnik e gjenocid ka bërë Serbia në Kosovë.

Prandaj unë e kam bërë vetëm detyrën time si qytetar i vendit tim. Unë jam veç një çlirimtar që luftën për liri e kam nisur me Adem Jasharin dhe e kemi përfunduar me gjeneralin Clarke, me NATO-n.

Unë sot këtu e kam për detyrë, por edhe e kam për nder të jem në anën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe aleatëve të kësaj ushtrie. Kjo më takon ta bëj dhe do ta bëj. Drejtësia, e mbi të gjitha, e vërteta, duhet të jenë qëllimi i të gjithë neve këtu, pse jo edhe i Prokurorisë, gjithsesi e juaja, e nderuar Gjykatë, ashtu siç është dhe do të jetë qëllimi im parësor në këtë proces gjyqësor.

Ju faleminderit.

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Selimi, faleminderit.

1 A mund ta përsëris pyetjen atëherë, që a mund të
2 konfirmoni që i kuptoni akuzat në Aktakuzë? Nuk po ju kërkoj a
3 pajtoheni me to, kuptohet, po ju kërkoj vetëm të thoni a i
4 keni kuptuar ato që shkruhen aty?

5 I AKUZUARI SELIMI: I nderuar z. Gjykatës. Po, i kam
6 lexuar dhe i kam kuptuar të gjitha ato që shkruhen në
7 Aktakuzë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit shumë.

9 Tani t'ju informoj për të drejtat që keni në këtë
10 Gjykatë. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e
11 Procedurës dhe e Provave ju garantojnë një numër të drejtash.
12 Do t'i lexoj më të rëndësishmet.

13 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm derisa të provohet
14 fajësia juaj përtej dyshimit të arsyeshëm;

15 Në përcaktimin e akuzave kundër jush, keni të drejtën për
16 një gjykim të drejtë dhe publik në varësi të masave që mund të
17 jepen për mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve;

18 Kenit të drejtën që të informoheni menjëherë dhe në
19 hollësi në një gjuhë që e kuptoni për natyrën dhe arsyet e
20 akuzave që janë ngritur kundër jush;

21 Kenit të drejtën të keni kohë dhe mjete, lehtësi të
22 mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen tuaj dhe të komunikoni
23 me avokatin që e zgjidhni vetë;

24 Kenit të drejtën që të gjykoheni brenda një kohe të
25 arsyeshme;

1 Keni të drejtën të gjykoheni në praninë tuaj dhe të
2 mbroheni përmes avokatit tuaj;

3 Keni të drejtën t'ju caktohet avokat pa pagesë në qoftë
4 se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar për mbrojtjen;

5 Keni të drejtën t'i bëni pyetje dëshmitarëve kundër jush,
6 ose që dikush t'u bëjë pyetje atyre në emrin tuaj, dhe të
7 kërkonit paraqitjen e dëshmitarëve dhe marrjen në pyetje të
8 tyre në emrin tuaj;

9 Keni të drejtën të ndihmoheni pa pagesë nga një përkthyes
10 nëse nuk e kuptoni gjuhën që flitet në Gjykatë;

11 Keni të drejtën të mos detyroheni të dëshmoni kundër
12 vetes ose të pranoni fajësinë;

13 Keni të drejtën që të qëndroni i heshtur dhe nuk do të
14 nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj;

15 Po kështu, keni të drejtën të bëni deklaratë pa betim që
16 lidhen me çështjen dhe mund të paraqiteni edhe si dëshmitar
17 nën betim;

18 Keni të drejtën të dorëzoni mocione paraprake për të
19 kundërshtuar juridiksionin e Dhomave të Specializuara, për të
20 pretenduar të meta në formën e Aktakuzës, dhe të kërkonit
21 ndarjen më vete të Aktakuzës;

22 Keni të drejtën që të merrni, brenda 30 ditësh nga
23 seanca e sotme, materialet mbështetëse të Aktakuzës që
24 dorëzohet për konfirmim -- që është dorëzuar për konfirmim;

25 Keni të drejtën të merrni të gjitha deklaratat e

1 dëshmitarëve që Prokurori i Specializuar ka ndërmend t'i
2 thërrasë për të dëshmuar në gjyq në një gjuhë që e kuptoni,
3 pra, në shqip;

4 Keni të drejtën të merrni menjëherë çfarëdo informacioni
5 që mund të sugjerojë në mënyrë të arsyeshme pafajësinë tuaj,
6 ose të zbusë fajësinë tuaj, ose që vë në dyshim -- ose që
7 ndikon në besueshmërinë e provave të Prokurorit të
8 Specializuar, sapo ky informacion të jetë në ruajtjen,
9 kontrollin apo dijeninë e tij;

10 Keni të drejtën që të gjitha materialet ose faktet
11 relevante që zotëron Prokuroria e Specializuar, t'ju vihen në
12 dispozicion para sesa të fillojë procesi dhe gjatë procesit.
13 Kjo e drejtë kufizohet vetëm nëse është rreptësisht e
14 nevojshme, ose kur zbatohen masa mbrojtëse balancuese;

15 Keni të drejtën që të mos mbaheni i paraburgosur për një
16 periudhë kohe të paarsyeshme para hapjes së çështjes gjyqësore
17 dhe të kërkonit rishikimin e vendimeve për paraburgim, si dhe
18 të bëni ankesë kundër këtyre vendimeve drejtpërsëdrejti para
19 Gjykatës së Apelit;

20 Keni të drejtën ta apelonit drejtpërsëdrejti në Gjykatën e
21 Apelit një vendim mbi mocionet paraprake që kundërshtojnë
22 juridiksionin e Dhomave të Specializuara;

23 Keni të drejtën që të kërkonit leje për të gjitha -- për
24 të bërë apel për të gjitha vendimet e tjera.

25 Z. Veseli //siç u përkthye// a i dëgjuat të drejtat më

1 kryesore që keni në përputhje me kornizën ligjore të Dhomave
2 të Specializuara?

3 I AKUZUARI SELIMI: Po. Konfirmoj që i dëgjova të gjitha.
4 Ju faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë.

6 Dua t'ju informoj se në bazë të nenit 21(5) të Ligjit, ju
7 nuk mund të përfaqësoni vetveten sepse për momentin jeni në
8 paraburgim. Përfaqësimi nga Mbrojtësi i Specializuar, pra,
9 është i detyruar.

10 Është detyra ime si Gjykatës i Procedurës Paraprake të
11 siguroj që të drejtat tuaja të respektohen - për të marrë
12 avokat. Për këtë qëllim kam marrë shënim parashtrimin e
13 Administratores për caktimin e avokatit kujdestar, mbrojtësit
14 kujdestar, për qëllimin e kësaj seance paraprake, dhe unë kam
15 shënuar gjithashtu faktin që ju keni ndërmend të merrni një
16 avokat që do të emërohet nga Administratorja.

17 Avokat, keni diçka për të thënë për këtë?

18 Z. KAARLS: [Përkthim] Nuk është për t'u çuditur mbas asaj
19 që dëgjuat nga klienti im, që ne do të bëjmë një kërkesë për
20 lirim të ndërkohshëm me kalimin e kohës.

21 Po desha të theksoj diçka në lidhje me këtë temë
22 përkatëse, se mbajtja në paraburgim apo arrestimi duhet të
23 bëhet dhe mbi baza solide, dhe kjo është p.sh., në rast se ka
24 rrezik të arratisjes.

25 Dua të theksoj që klienti im ka bashkëpunuar dhe më

1 përpara - dhe ajo që tha ai tani për mënyrën e arrestimit -
2 javën që kaloi ai u kontaktua nga Zyra e Prokurorit të
3 Specializuar dhe ai u dorëzua vetë.

4 Pra, këto janë indikacione solide, specifike që nuk ka --
5 nuk ekziston rreziku i arratisjes.

6 Për më tepër, klienti im - çfarëdo që mendon ai në lidhje
7 me këto pretendime kundër tij, apo për këtë proces, apo për
8 këtë Gjykatë, nuk ka asnjë lloj indikacioni që të kemi ne deri
9 tani - dhe kjo është e rëndësishme - pra, klienti im z.
10 Selimi, nuk ka asnjë lloj indikacioni që ai do të influencojë
11 te dëshmitarët apo do të asgjësojë provat apo ndonjë diçka
12 tjetër.

13 Pra, këto janë në thelb parashtrimet tona, por ne do t'i
14 japim ato me shkrim me kalimin e kohës.

15 Pra, për sa i përket atij, nuk ka asnjë lloj arsye për të
16 besuar se z. Selimi - nuk e di se çfarë kanë bërë të tjerët,
17 çfarë do të bëjnë në të ardhmen e të tjera, për të tjerët nuk
18 e dimë - por nuk ka asnjë indikacion se z. Selimi do të
19 ndikojë në prova apo do të bëjë diçka të tillë.

20 Këtë e ka theksuar -- e theksoi edhe vetë z. Selimi tani,
21 që ai do të bashkëpunojë plotësisht me këtë Gjykatë dhe do të
22 japë të gjitha përgjigjet sipas nevojës kur të pyetet dhe kur
23 t'i kërkohet.

24 Këtë kisha për të theksuar në këtë moment.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Kaarls.

1 A mund t'ju kërkoj që në orët dhe ditët e ardhshme të
2 lidheni me klientin tuaj dhe t'i bëni parashtimet e duhura
3 Administratores në lidhje me caktimin tuaj, me emërimin e
4 avokatit.

5 Dhe i kërkoj Administratores që të parashtojë një
6 dokument që më informon për vendimin që do të marrë në këtë
7 çështje.

8 Tani do t'i kthehem mundësisë që z. Selimi të
9 vetëdeklarohet, në qoftë se dëshiron, në pajtim me rregullën
10 92.

11 Z. Selimi, brenda 30 ditësh nga sot, juve do të ftoheni
12 të pranoni fajësinë ose të vetëdeklaroheni i pafajshëm. Në
13 qoftë se dëshironi mund ta bëni menjëherë, të pranoni fajësinë
14 apo të vetëdeklaroheni i pafajshëm.

15 Pra, z. Selimi, ju pyes a keni pasur mundësinë t'i
16 diskutoni akuzat në Aktakuzën e Konfirmuar me avokatin tuaj,
17 dhe a jeni i gatshëm të deklaroheni në këtë moment? Dhe në
18 qoftë se do ta bëni këtë, ju lutem çohuni në këmbë kur të
19 vetëdeklaroheni.

20 I AKUZUARI SELIMI: Po, i nderuar Kryetar. Unë kam pasur
21 kohë të mjaftueshme që bashkë me avokatin tim ta shoh
22 Aktakuzën, ta analizoj, ta kuptoj, dhe më lejoni që sot këtu
23 të deklarohej që ndihem i pafajshëm për të gjitha pikat në
24 Aktakuzë. Ju faleminderit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.

1 Dua t'ju kërkoj një sqarim, se mund të jetë problem i
2 përkthimit. Ju thatë që ndiheni i pafajshëm -- ju thatë që
3 "ndihem i pafajshëm", por ne për arsye procedurale na duhet që
4 ta kemi një fjali shumë të qartë nga ju që vetëdeklaroheni i
5 pafajshëm.

6 I AKUZUARI SELIMI: Unë zakonisht i deklaroj ato çka i
7 ndiej, por po e përsëris edhe njëherë atëherë për procedurë.
8 Unë deklarohe i pafajshëm në të gjitha pikat e Aktakuzës.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.
10 Është shumë e qartë.

11 Tani të kaloj te gjuha e punës e këtij procesi. Në
12 urdhrin për caktimin e datës së kësaj seance të parë, unë u
13 kërkova palëve që të bënin parashtime në lidhje me gjuhën që
14 do të përdoret, në bazë të rregullës 8.

15 Z. Prokuror, e di që e keni thënë tre herë mendimin tuaj,
16 por a mund ta thoni dhe për këtë rast.

17 Z. TIEGER: [Përkthim] Ne vazhdojmë të jemi të mendimit që
18 gjuha e punës të jetë anglishtja.

19 Z. KAARLS: [Përkthim] Edhe Mbrojtja ka të njëjtën kërkesë
20 që gjuha e punës të jetë anglishtja.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

22 Do të jap një urdhrë me kalimin e kohës në lidhje me këtë
23 çështje.

24 Sikurse u tha në urdhrin në lidhje me këtë Paraqitje të
25 Parë, unë do të bëj -- do të caktoj datën e një Konference për

1 Ecurinë e Çështjes, në bazë të rregullës 96, mbasi të jenë
2 bërë këto seancat e para. Qëllimi është që të shihet ku është
3 gjendja e çështjes, të bëhen shkëmbimet midis palëve dhe të
4 sigurojmë një përgatitje të shpejtë të gjyqit.

5 Z. Selimi, desha t'ju kujtoj që ju keni të drejtën të
6 merrni pjesë në këto seanca ose Konferenca për Ecurinë e
7 Çështjes me avokatin tuaj, por mbasi të keni marrë këshilla
8 nga avokati juaj dhe me lejen tuaj me shkrim, në bazë të
9 rregullës 96(2), Konferenca për Statusin e Çështjes mund të
10 ndiqet nga ju në person dhe avokati të jetë me videolidhje; me
11 avokatin që të jetë i pranishëm këtu dhe ju z. Selimi mund të
12 jeni me videolidhje, ose mund të kryhet në mungesën tuaj, kur
13 avokati juaj merr pjesë ose në sallën e gjyqit ose përmes
14 videolidhjes.

15 Tani më lejoni t'u kërkoj palëve që të japin përshtypjet
16 dhe opinionet e tyre sa i takon një date të përshtatshme për
17 organizimin e statusit për gjendjen gjyqësore më datë 18
18 nëntor, ditën e mërkurë, ose në një datë të mëvonshme.

19 Do të doja të më thoni në qoftë se është e mundur dhe në
20 qoftë se e dini, në qoftë se Mbrojtja do të marrë pjesë
21 fizikisht apo përmes videokonferencës.

22 Z. TIEGER: [Përkthim] Sërish më lejoni të them, z.
23 Gjykatës, që ne jemi të disponueshëm qoftë më datë 18 apo në
24 një datë më vonë, ashtu siç të vendoset prej jush.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mbrojtja.

1 Z. KAARLS: [Përkthim] Faleminderit. Edhe neve duam që të
2 shprehemi që jemi në dispozicion sipas datës që do të
3 përcaktohet nga Gjykatësi, por do t'ju kërkonim që të
4 përcaktonit një datë sa më vonë të jetë e mundur brenda këtij
5 muaji, sepse në fakt David Young dëshiron që të jetë i
6 pranishëm fizikisht vetë këtu. Edhe nga tjetër e dimë që
7 Prokuroria ka pasur kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur,
8 ndërkohë që ne sapo jemi futur në këtë çështje, në këtë lëndë.

9 E dimë që kemi çështje edhe me parashtrimet, me afatet
10 kohore dhe me pjesën e nxjerrjes së informacionit, por siç e
11 thashë edhe njëherë, në qoftë se do të ishte e mundur, i
12 nderuar Gjykatës, do të ishte mirë që të kishim një seancë sa
13 më vonë gjatë muajit.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Mbrojtja.

15 Pra, siç e thashë edhe më përpara, duhet që të kemi një
16 balancë ndërmjet dhënies së kohës së përshtatshme për të
17 gjitha palët, por nga ana tjetër nuk duhet që të pengojmë
18 nxjerrjen e informacionit pasi një gjë e tillë është në
19 përputhje me interesat e të gjitha palëve.

20 Ju do të merrni urdhrin e planifikimit për seancën e
21 radhës në kohën e duhur. Gjithashtu do të doja të them që
22 synoj që të përcaktoj një datë për sa i takon Prokurorisë për
23 të dhënë parashtrimet e veta deri më datë 13 nëntor, ditë e
24 premtë, dhe do të përcaktoj datën 17 për Mbrojtjen.

25 Dhe pas Konferencës për Statusin, unë do të nxjerr një

1 vendim për detyrimin për nxjerrjen e informacionit për
2 Prokurorinë në përputhje me rregullën 102 dhe në përputhje me
3 regjimin e redaktimit për procedurën.

4 Në këtë pikë do të doja t'u kërkoja palëve në qoftë se ka
5 ndonjë gjë tjetër që duan të ngrenë. Edhe do të doja t'u
6 kujtoj palëve që në qoftë se do të zbulojnë informacion
7 konfidencial, të mund të na e thonë këtë gjë në mënyrë që të
8 mund të marrim masat e nevojshme.

9 Z. Prokuror, po ashtu edhe ju keni fjalën në qoftë se
10 doni të thoni diçka sa i takon parashtrimeve të cilat u bënë
11 nga Mbrojtja para pak minutash.

12 Z. TIEGER: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Gjykatës.

13 Sigurisht që neve do t'i përgjigjemi në detaje çdo
14 parashtrimi që do të depozitohet nga Mbrojtja që ka të bëjë me
15 faktorët përcaktues për ndalimin e ndërmjetëm dhe për sa i
16 takon edhe paraburgimit, ndalimit në burg të të akuzuarit.
17 Kështu që, në momentin që do t'i marrim parashtrimet e
18 Mbrojtjes do t'i përgjigjemi në detaje të gjitha këtyre
19 pretendimeve.

20 Përveç këtyre nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar nga ana
21 e Prokurorisë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

23 Z. Avokat.

24 Z. KAARLS: [Përkthim] Për momentin ne nuk kemi asgjë për
25 të shtuar. Siç thashë do të depozitojmë parashtrimet në kohën

1 e duhur.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Tani më lejoni t'i kërkoj të akuzuarit në qoftë se ka
4 ndonjë gjë tjetër për të shtuar lidhur me arrestimin, me
5 transferimin ose me paraburgimin e tij.

6 Z. Selimi, a keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me këto
7 çështje?

8 I AKUZUARI SELIMI: Jo, nuk kam për të shtuar diçka në
9 veçanti. Unë i kuptoj rregullat për të ardhur deri këtu,
10 prandaj nuk kam diçka që mund ta nxjerr si vërejtje.
11 Faleminderit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Selimi.

13 Së fundi, dua t'ju informoj që do të nxjerr një urdhër që
14 e urdhëron Zyrën e Prokurorit të Specializuar edhe Zyrën e
15 Administratores për të riklasifikuar dosjen sipas versioneve
16 të paredaktuara, sipas rastit, në mënyrë që Mbrojtja t'i ketë
17 këto informacione dhe këto dosje sa më shpejt të jetë e
18 mundur.

19 Z. Selimi, ndërkohë që ju jeni i paraburgosur, do të doja
20 që t'ju informoja që ju mund të kundërshtoni burgosjen tuaj në
21 përputhje me rregullën 57.

22 Ky është fundi i seancës së ditës së sotme. Do të doja të
23 falënderoja palët për pjesëmarrjen. Dua të falënderoj po ashtu
24 edhe përkthyesit, stenografët, personelin e mbrojtjes dhe
25 teknikët audiovizivë. Kështu që faleminderit për vëmendjen dhe

1 këtua mbyllet seanca.

2 --- Seanca e Paraqitjes së Parë përfundon në

3 orën 11.44

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25